## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**

Për: **208 Udheheqesi-21-2070-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i sallës së sporteve "Naim Frashëri" në Podujevë**

# ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit***

**Astraplan SHPK & ECM Engineering SHPK**
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rr. Mehmet Gradica Hyr. 5/6, Bregu i Diellit**
*(Adresa)*

**Prishtinë** **10000**
*(Vendi)* *(Kodi postar)*

**038 555 045** **038 555 045**
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

**Florim Istrefi**
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**astra_plan@hotmail.com**
*(Adresa elektronike)*

**23.07.2021**
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

| |
|---|
| *Publikimi i tenderit ka qene ne E-PROKURIM, publikimi i tenderit është bere me datën 26.04.2021 ndërsa hapja e ofertave është me datën 07.05.2021 13:30, si kriter i tenderit, tenderuesi i përgjegjshëm çmimi me i ulet.* |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

**Po** ☐ **Jo** ☒

| |
|---|
| JO, hapja është bere përmes e-prokurimit |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

| |
|---|
| Me datën 13.07.2021 kemi bere kërkesë për RI-SHQYRTIM pran AK-s, duke kërkuar qe te ri-shqyrtojnë vendimin e marre ne lidhje me këtë aktivitet, ku me datën 15.07.2021 AK na kthen përgjigje duke e refuzuar kërkesën tone si te pa bazuar. |

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

| |
|---|
| **Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi** |
| **Nenit 8 i LPP-së - Planifikimi i Prokurimit** |
| **Nenit 9 i LPP-së - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur** |
| **Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës** |
| **Neni 56 i LPP-së-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave** |
| **Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** |
| **Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës** |
| **Neni 62 i LPP-së - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit** |
| **Neni 41 te RRUOPP-s - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve te RRUOPP-s** |
| **Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve** |

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Fillimisht munde te konstatojmë se ky anulim është jo valid dhe ne kundërshti te plote me LPP-n, sepse ka shkelje te shume neneve te LPP-s, dhe përveç këtyre shkeljeve shkelja e radhës dhe anulimi i dyshimte është sepse vendimi mbi anulimin e aktivitetit ne fjale nuk është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor i Prokurimit te MASH.**

**Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 7, ka anuluar tenderin vetëm e vetëm pse ne si konzorcium kemi qen me te lirët, kështu qe nuk i ka trajtuar te gjithë OE-t te barabartë, sepse po te ishte me i lire ndonjë OE tjetër qe ju përshtatet zyrës se prokurimit dhe zyrës se menaxhimit te projekteve ne MASH, procedura do te përfundohej brenda 2-3 jave, siç ka ndodhe zakonisht me aktivitetet tjera qe Ne si OE nuk kemi qene me çmim me te lirët.

**Nenit 8 i LPP-së - Planifikimi i Prokurimit**
Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 8 pasi kanë planifikuar mjetet për vitin fiskal dhe nuk është realizuar kontrata e punëve.

**Nenit 9 i LPP-së - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur**
Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 9, pasi qe para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave për ketë Aktivitet te Prokurimit.
Me këtë vlerësim te nevojave përcaktohen lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; gjate aktivitetit .

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te 9.2 dhe 9.3 pas vlerësimit te nevojave ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton për inicimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës te tenderit. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik , ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të filloj me publikim te tenderit.

**Neni 10 i LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës**
Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te këtij neni pasi qe kemi kërkuar qasje qe ne dokumente si pale e interesit dhe nuk na ka ofruar qasje.

**Nenit 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
Autoriteti Kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 59 duke bere shkelje flagrante te këtij neni, për shkak se ne si OE i plotësojmë te gjitha kërkesat ne njoftim

për kontrate dhe DT, anulimi i tenderit është ne kundërshtim të plotë me nenin 59, paragrafin 4, citojmë paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-s, qe do te thotë se sipas përgjigjes ne qasje ne dokumente nuk kane vlerësuar fare tenderët qe për neve si OE është e pa besueshme, e nëse veç nuk i kane vlerësuar ofertat kane bere shkelje flagrante te LPP-s, saktësisht 59 dhe nenit 62.

*"Citojmë nenin 59 te LPP-s"* *("Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.").*

**Neni 56 i LPP-së-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 56 pasi nuk i ka vlerësuar ofertat dhe përzgjedhjen e OE-ve për dhënie te kontratës sipas këtij neni. Neni 56 paragrafi 3 e sqaron qarte se nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

*(citojmë paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-s)*

3. *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

**Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës**

Autoriteti kontraktues ka bere shkeljen e këtij neni pasi qe nuk është lëshuar fare ne vlerësim te ofertave, dhe ne kundërshtim me nenin 60 nuk na ka shpallur fitues duke bere shkelje te këtij neni saktësisht paragrafin 1 i cili thotë: citojmë paragrafin 1 te nenit 60 te LPP-s

*("1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:*

*1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;*

*1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është")*

**Neni 62 i LPP-së - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**

Autoriteti kontraktues ka bere shkeljen e këtij neni pasi qe nuk është lëshuar fare ne vlerësim te ofertave, me qellim vetëm e vetëm se Ne kemi qen me te lirët si grup i OE-ve, arsyeja e anulimit te procedurës se këtij aktiviteti nuk qëndron dhe është absurde ku thuhet se AK-ja do te shtoj edhe disa pune ne këto objektet siç janë izolimi akustik dhe sistemi i ajrimit, arsye e cila nuk është e bazuar ne asnjë nen te LPP-s, pasi qe këto salla janë duke u ndërtuar qe disa vite te njëjtat dhe çfarëdo sistemi i ventilimit dhe izolimit akustik munde te kryhet me një tjetër aktivitet te prokurimit sepse është i ndare nga punët ne projektin qe është realizuar deri me tani dhe nuk ka asnjë pengese qe me vone te kryhen nëse dëshirojnë. Vlerësimi i ofertave duhet te vazhdoj tutje me shpalljen e fituesit qe i plotëson te gjitha kushtet ne njoftim për

kontrate dhe ne dosje te tenderit. Sa i përket projektit AK-ja ne këtë faze nuk e ka asnjë te drejte qe te ndërpres aktiviteti dhe te kërkoj ndryshim projekti, kjo nuk parashihet ne paragrafin 2.1 dhe 2.2 te nenit 62 te LPP-s dhe është ne kundërshtim te plote me këtë nen.
E kuptojmë se jua kemi prishe matematikat, ne momentin e anulimit dyshojmë se e keni vërejtur se OE me çmimin me te lire ne këtë aktivitet nuk i plotëson kushtet dhe duke qen Ne jemi si OE i dyte me radhe qe i plotësojmë kushtet, nuk janë plotësuar matematikat qe vetëm Ju si AK dini ti bëni mirëpo procedurën duhet te përfundoni, konform nenit 62 paragrafit 2 te LPP-s,

- **Për te vërtetuar pohimet Tona se qëllimisht është anuluar proceduar e prokurimit, vetëm pse ne kemi qen si OE i dyte me radhe me çmimin me te lire , si dështmi e kemi njoftimin (vendimin) nga AK-ja për anulimin e procedurës, ne te cilin figurojmë ne si Grup i OE qe e kemi dorëzuar ofertën sipas hapjes se ofertave te datës 07.05.2021 , kjo nuk donë koment, këtu jemi ne liste se jemi i dyti me radhe ndërsa ne Istog nuk jemi sepse jemi i pari me radhe.**

Ne vazhdim *citojmë nenin 62, paragrafin2, pikat 2.1 dhe 2.2*
*2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*

*2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo*
*2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.*
*Ne foton e me poshtme po ju rikujtojmë shkeljen e LPP-s.*

Arsyet e anulimit jan keto te cilat jan në publik

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Autoriteti Kontraktues **anulon**[1] aktivitetin e prokurimit
Një gabim ka ndodhur në hartimin e paramasave në FDT,së, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit.
Projekti i sallave duhet të ndryshohet, në të gjitha sallat duhet të inkorporojmë edhe pozicionet e izolimit akustik dhe sistemin e ajrimit.

Data: 09.07.2021

Emri dhe mbiemri i ZPP: Xhemajl Buzuku

_____

- NJOFTIM PER QASJE NE DOKUMENTA

41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve te RRUOPP-s

AK-ja ka vepruar ne kundërshtim te plote me këtë nen pasi qe i ka shkelur te gjitha afate kohore deri ne ditën qe na ka njoftuar për vendimin e mare ne lidhje me këtë procedure. Ofertat janë dorëzuar me *07.05.2021, data e njoftimit me 09.07.2021, d.m.th. janë 64 dite nga data e dorëzimit deri te data e njoftimit, ndërsa sipas LPP-s afatet për përfundimin e vlerësimit janë 30 dite, ne raste te jashtëzakonshme për kontrata komplekse +20 dite.*

Ne vazhdim *citojmë nenin 41, paragrafin 41.1 dhe 41.2 te RRUOPP-s*

*41.1 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHPsë përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.*

*41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda përiudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo përiudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.*

*41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë:*

1. **Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.**

2. **Tenderët duhet ët jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).**

3. **Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.**

4. **Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.**

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
94

5. **Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.**

6. **Asnjë negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP.**

7. **Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim t kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se.**

8. **Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.**

**Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

Është për tu çuditur fakti se si zyra e prokurimit nuk na lejon qasje ne dokumente!!!!!!!!!

**Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, nga OSHP kërkojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës sonë të bëjë sintezën dhe analizën e dyshimeve, kërkesave dhe pretendimeve të ngritura në këtë ankesë dhe se këtë aktivitet prokurimi ta kthej në *RI-VLERËSIM pasi qe e plotësojmë kushtin e interesit material ne kete aktivitet te prokurimti dhe mund te jemi* tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, nëse OE me i lire sipas hapjes nuk i plotëson kushtet, qe do te thot se me pa tjetër duhet te behet vlerësimi i ofertave.***

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Humbja e kohës, shpenzimet material ne përgatitjen e ofertës, fitim i humbure sepse po te behej vlerësimi real dhe sipas kushteve ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, Ne do te munde te ishim fituesit potencial te kësaj oferte nga komisioni vlerësues, *pasi qe e plotësojmë kushtin* Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulet, nëse OE me i lire sipas hapjes nuk i plotëson kushtet, qe do te thot se me pa tjetër duhet te behet vlerësimi i ofertave.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*